

VENDIM
Nr.548, datë 11.8.2011

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.718, DATË 23.6.2009 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR PAGAT E PUNONJËSVE TË PERSONELIT TË HETIMIT, TË
INSPEKTIMIT DHE TË SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE, NË SHËRBIMIN E
KONTROLLIT TË BRENDSHËM NË MINISTRINË E BRENDSHME”, TË
NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2 të nenit 4 të ligjit nr.10 405, datë 24.3.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, të nenit 51 të ligjit nr.10 002, datë 6.10.2008 “Për Shërbimin e Kontrollit të Brendshëm në Ministrinë e Brendshme” dhe në ligjin nr.10 355, datë 2.12.2010 “Për buxhetin e vitit 2011”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.718, datë 23.6.2009, bëhen këto ndryshime:

a) Lidhja nr.1 “Struktura dhe nivelet e pagave, për punonjësit e personelit hetues të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm”, e përmendur në pikën 1, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe emërtim, bashkëlidhur këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.”.

b) Lidhja nr.2 “Struktura dhe nivelet e pagave, për punonjësit civilë inspektues dhe mbështetës të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm”, e përmendur në pikën 6, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe emërtim, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

c) Lidhja nr.3, e përmendur në pikën 8, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe emërtim, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, do të përballohen nga fondet e parashikuara në buxhetin e shtetit për rritjen e pagave, për vitin 2011.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrinë efektet financiare nga data 15 korrik 2011.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha